



UK Health
Security
Agency



Jeni shtatzënë?

**Këto vaksina ndihmojnë për
t'ju mbrojtur ju, fëmijën tuaj
dhe shtatzëninë tuaj**

Gripi (Influenza)

Kolla e mirë
(pertussis)

**Virusi sincial
i frymëmarrjes** (RSV)

Me këshilla shtesë lidhur
me vaksinat e tjera dhe
kur t'i merrni ato

immunisation



**Në këtë fletëpalosje tregohen vaksinat
falas që ndihmojnë për t'ju mbrojtur**

- ju
 - shtatzëninë tuaj dhe
 - fëmijën tuaj të sapolindur
- nga komplikacionet e infeksionit**

Si funksionojnë vaksinat?

Vaksinat ndihmojnë mbrojtjen natyrale të trupit tuaj (sistemin imunitar) për të njohur dhe luftuar disa sëmundje infektive.

Kur bëni një vaksinë, sistemi juaj imunitar forcohet për të ndihmuar në parandalimin e sëmundjes dhe për të mbrojtur shtatzëninë tuaj. Më pas, antitruPAT i kalojnë fëmijës suaj ende të palindur për ta mbrojtur nga lindja dhe në javët e muajt e parë të jetës.

A mund ta ushqej me gji fëmijën tim pasi kam bërë një vaksinë?

Po, nuk ka problem ta ushqeni fëmijën tuaj me gji pasi keni bërë vakSina kundër MMR, gripit, kollës së mirë dhe RSV. Për disa vakSina të bëra gjatë ose pas shtatzënisë, qumështi juaj i gjirit do të ketë antitruPA në të, ndaj ju mund të vazhdoni të ndani mbrojtjen tuaj me fëmijën tuaj duke ushqyer me gji.

Vaksinat e bëra gjatë shtatzënisë

Kolla e mirë (pertussis)

Kolla e mirë është një sëmundje shumë infektive e cila mund të jetë tepër e rëndë për foshnjat e vogla. Shumica e foshnjave me kollë të mirë kanë kenë nevojë për shtrim në spital.

Kolla e mirë mund të shkaktojë shpërthime të gjata të kollitjes dhe mbytjes, duke e bërë të vështirë frymëmarrjen. Zhurma "hup" shkaktohet nga gulçimi për të marrë frymë pas çdo kollitjeje.

Kolla e mirë mund të zgjatë rreth 2 ose 3 muaj. Ajo mund të çojë në pneumoni, kriza dhe dëmtim të përhershëm të trurit. Në rastet më të këqija mund të shkaktojë vdekje.

Pse është e nevojshme ta bëj vaksinën kundër kollës së mirë?

Bërja e vaksinës vaksine kundër kollës së mirë gjatë shtatzënisë ju ndihmon të jeni më të mbrojtur. Antitrupe që prodhon trupi juaj do të kalojnë gjithashtu përmes placentës te fëmija juaj. Këta antitrupe do ta mbrojnë fëmijën tuaj kundër kollës së mirë gjatë javëve të para të jetës.



Jeni shtatzënë? – Vaksinat para, gjatë dhe pas shtatzënisë suaj

Kur duhet ta bëj vaksinën?

Normalisht do ta bëni vaksinën kundër kollës së mirë rreth kohës kur të bëni skanerin në mes të shtatzënisë (zakonisht 20 javë), por mund ta bëni që në javën e 16-të.

Nëse keni arritur në javën e 20-të të shtatzënisë dhe nuk e keni bërë ende vaksinën, flisni me mjekun tuaj të përgjithshëm ose maminë dhe lini një takim për ta bërë vaksinën sa më shpejt të jetë e mundur.

Për t'i siguruar fëmijës tuaj mbrojtjen më të mirë, duhet të synoni ta bëni vaksinën para javës së 32-të. Nëse e kaloni këtë afat, prapë mund ta bëni vaksinën më vonë, edhe pse efekti i saj mund të jetë më i ulët. Nëse nuk ka qenë e mundur ta bënit vaksinën para se të lindnit, mund ta bëni më pas, dhe kjo do të ulë rrezikun që t'ia transmetoni kollën e mirë fëmijës suaj. Është e rëndësishme që ta bëni vaksinën kundër kollës së mirë gjatë shtatzënisë për të rritur nivelet e antitrapave dhe për ta mbrojtur fëmijën tuaj.

Mendoja se vaksina kundër kollës së mirë u bëhej foshnjave?

Në Mbretërinë e Bashkuar, foshnjave u bëhet vaksina kundër kollës së mirë në moshën 8, 12 dhe 16 javëshe. Shumë foshnja që janë sëmurur rëndë me kollën e mirë janë të infektuar në javët e para të jetës. Mënyra e vetme për të mbrojtur fëmijën në këtë kohë është duke bërë vaksinën e kollës së mirë gjatë kohës që jeni shtatzënë.

Sa e efektshme është vaksina?

Studimet në Mbretërinë e Bashkuar kanë treguar se bërja e vaksinës gjatë shtatzënisë është rreth 90% e efektshme për të parandaluar kollën e mirë të foshnjat e sapolindura.

Mbrojtja që merrni nga vaksina do të thotë gjithashtu se keni më pak gjasa të sëmureni me kollën e mirë dhe t'ia transmetoni fëmijës.

Cilën vaksinë do të bëj?

Vaksina që japim gjatë shtatzënisë siguron gjithashtu mbrojtje kundër tetanosit dhe difterisë. Ajo forcon mbrojtjen që keni marrë nga vaksinat e zakonshme të fëmijërisë.

Ju mund të lexoni rreth vaksinës Adacel këtu:

www.medicines.org.uk/emc/product/15553/pil#gref

A është e sigurt bërja e vaksinës kundër kollës së mirë gjatë shtatzënisë?

Shumë vende në Evropë, Amerika Veriore dhe Jugore, Australia dhe Zelanda e Re përdorin vaksinën kundër kollës së mirë gjatë shtatzënisë, dhe ajo ka një rekord të shkëlqyer sigurie.

Është shumë më e sigurt për ju dhe foshnjën tuaj të bëni vaksinën sesa të rrezikoni që foshnja juaj se sapolindur të infektohet me kollën e mirë.

 **Mbrojeni fëmijën dujke e bërë vaksinën kundër kollës së mirë gjatë çdo shtatzënie. Sigurohuni që fëmija juaj ta bëjë vaksinën kundër kollës së mirë në javën 8, 12 dhe 16.**

Virusi sincial i frymëmarrjes (RSV)

Virusi sincial i frymëmarrjes ose RSV është një virus i zakonshëm që mund të shkaktojë një infeksion të mushkërive të quajtur bronkiolit. Te foshnjat e vogla, kjo gjendje mund ta bëjë të vështirë frymëmarrjen dhe të ushqyerit. Në Angli, rreth 20,000 foshnja shtrohen në spital çdo vit me bronkiolit, dhe disa kanë nevojë për kujdes intensiv. Një numër i vogël vdesin.

RSV ka më shumë gjasa të jetë serioz te foshnjat shumë të vogla, ato të lindura para kohe dhe ato që kanë probleme shëndetësore që prekin zemrën, frymëmarrjen ose sistemin imunitar. Infeksionet RSV mund të ndodhin gjatë gjithë vitit, por rastet arrijnë kulmin në dimër.

Pse duhet ta bëj vaksinën kundër RSV?

Bërja e vaksinës kundër RSV gjatë shtatzënisë bën që të jeni më të mbrojtur. Antitruapat që trupi juaj prodhon kalohen te foshnja i palindur ende. Këta antitropa e mbrojnë fëmijën kundër kollës së mirë gjatë javëve të para të jetës.

Kur duhet ta bëj vaksinën?

Vaksina do t'ju ofrohet rreth kohës që keni takimin 28-javësh të shtatzënisë.

Ju duhet të përpiqeni ta bëni vaksinën në javën e 28-të ose sa më shpejt të jetë e mundur pas kësaj. Kjo do t'ju ndihmojë të krijoni një nivel të mirë të antitropave që t'ia fëmijës përpara se të lindni.

Vaksinën mund ta bëni edhe më vonë gjatë shtatzënisë, edhe pse efekti është më i ulët. Nëse nuk ka qenë e mundur ta bënit më herët një dozë, mund ta bëni deri para se të lindni.

Duhet ta bëni vaksinën kundër RSV në çdo shtatzëni për t'i dhënë fëmijës suaj të sapolindur mbrojtjen më të mirë.

Sa e efektshme është vakcina kundër RSV?

Studimet tregojnë se vaksinimi kundër RSV ul me 70% rrezikun që foshnja juaj të sëmuret me bronkiolit të rëndë gjatë 6 muajve të parë të jetës.

Ashtu si të gjitha mjekimet, asnjë vaksinë nuk është plotësisht efektive dhe disa foshnja mund të infektohen ende me RSV edhe pse nënat e tyre e kanë vaksinën. Megjithatë, për shumicën e foshnjave të lindura nga nëna të vaksinuara, çdo infektion RSV duhet të jetë më pak i rëndë.

Cilën vaksinë do të bëj?

Mund të lexoni rreth saj këtu: www.abrysv.com/

A është vakcina kundër RSV gjatë shtatzënisë e sigurt për fëmijën tim?

Në një eksperiment klinike me pothuajse 4000 gra, vakcina kishte një rekord të mirë sigurie dhe tani është miratuar nga entet rregullatore të barnave në MB, Evropë dhe SHBA. Që nga ajo kohë, mijëra gra e kanë bërë vaksinën në programet kombëtare, duke përfshirë më shumë se 100,000 gra në SHBA.

Në eksperimentin klinike, pak më shumë foshnja lindën herët në grupin e vaksinës sesa në grupin që nuk kishte bërë vaksinë. Ky ndryshim duket se është për shkak të rastësisë, por kjo është një arsye pse vakcina jepet nga java e 28-të dhe jo më herët në shtatzëninë tuaj. Në përgjithësi është shumë më e sigurt për ju dhe foshnjën tuaj të bëni vaksinën sesa të rrezikoni që foshnja juaj të infektohet me RSV.



Bëni vaksinën kundër RSV ndërsa jeni shtatzënë për t'i dhënë fëmijës tuaj mbrojtjen më të mirë për 6 muajt e parë të jetës.

Influenza (gripi)

Çfarë është gripi?

Gripi është një sëmundje shumë infektive me simptoma të tilla si ethe, të dridhura, dhimbje, dhimbje koke dhe lodhje ekstreme. Gratë shtatzëna janë më të rrezikuara që t'u shfaqen komplikacione të rënda të gripit, veçanërisht në fazat e mëvonshme të shtatzënisë, duke përfshirë pneumoninë dhe madje edhe vdekjen.

Gripi gjithashtu mund të rrezikojë shtatzëninë tuaj, duke çuar në lindje të parakohshme, peshë të ulët të lindjes dhe lindje pa jetë.

Gripi gjithashtu mund të jetë jashtëzakonisht i rëndë për foshnjat e sapolindura dhe foshnjat e vogla.

Pse duhet ta bëj vaksinën kundër gripit gjatë shtatzënisë?

Vaksina e gripit ul rrezikun që të sëmureni rëndë me grip, nevojën për shtrimin në spital ose për kujdes intensiv gjatë shtatzënisë. Gjithashtu ul rrezikun e komplikacioneve të shtatzënisë.

Vaksina rrit antitruapat kundër gripit, të cilat më pas i kalojnë fëmijës suaj të palindur ende. Kjo siguron mbrojtje për fëmijën tuaj të sapolindur në muajt e parë të jetës.

Gjithashtu do të ketë më pak gjasa të prekeni nga gripi dhe t'ia kaloni atë foshnjës tuaj të sapolindur gjatë dimrit.

Kur duhet ta bëj vaksinën?

Vaksina kundër gripit zakonisht ofrohet nga shtatori i çdo viti dhe është falas për gratë shtatzëna.

Ju duhet ta bëni vaksinën pasi të jetë e disponueshme në shtator, pavarësisht se në cilën fazë të shtatzënisë jeni. Është më mirë ta bëni vaksinën tuaj përpara se të fillojë sezoni i gripit, megjithëse mund ta bëni vaksinën në çdo kohë gjatë dimrit.

Ju do të keni nevojë për një vaksinë gripi sa herë që jeni shtatzënë gjatë sezonit të gripit.

A është e sigurt bërja e vaksinës kundër gripit gjatë shtatzënisë?

Që nga viti 2009, shumë vende kanë ofruar një vaksinë gripi gjatë shtatzënisë, dhe mbi 2 milionë vaksina u janë dhënë grave shtatzëna në Angli. Vaksina ka një rekord të shkëlqyer sigurie.

Në përgjithësi është shumë më e sigurt ta bëni vaksinën sesa të rrezikoni që ju ose foshnja juaj të infektohet me grip.

Sa e efektshme është vaksina kundër gripit?

Bërja e vaksinës kundër gripit gjatë shtatzënisë përgjysmon rrezikun që ju ose foshnja juaj të sëmurëni me grip ose me ndonjë sëmundje ngjashëm gripit. Foshnjat e lindura nga gra të vaksinuara kanë rreth 70% më pak gjasa për t'u shtruar në spital për shkak të gripit gjatë 6 muajve të parë të jetës.

» Gripi mund të jetë një sëmundje serioze për gratë shtatzëna dhe foshnjat e tyre. Gratë shtatzëna duhet ta bëjnë falas vaksinën kundër gripit gjatë çdo shtatzënie. Mund të bëhet në çdo fazë të shtatzënisë duke filluar nga shtatori.

Çfarë duhet të bëj tani?

Mund të flisni me mjekun tuaj të përgjithshëm, maminë ose ekipin shëndetësor për të lënë një takim për të bërë vaksinat. Vaksinat kundër gripit, kollës së mirë dhe RSV jepen të gjitha si një injeksion i vetëm në krah. Efektet anësore të zakonshme janë të lehta dhe përfshijnë:

- dhimbje dhe skuqje në vendin e injektimit
- dhimbje koke dhe dhimbje muskujsh
- temperaturë e lehtë ose lodhje

Ju mund të lexoni fletushkën rreth gripit këtu:

www.gov.uk/government/publications/flu-vaccination-who-should-have-it-this-winter-and-why


Para se të mbeteni shtatzënë

Nëse nuk jeni ende shtatzënë, por shpresoni të mbeteni shtatzënë në të ardhmen e afërt, duhet të siguroheni që i keni bërë vaksinat e tjera.

Rubeola (fruthi gjerman)

Infeksioni i rubeolës është normalisht një infektion i lehtë që shkakton një sëmundje të skuqjes së lëkurës.

Infektimi me rubeolë gjatë shtatzënisë mund të jetë shumë serioz për fëmijën tuaj, duke shkaktuar një sëmundje të quajtur sindroma e rubeolës kongjenitale (CRS). CRS mund të çojë në shurdhim, verbëri, katarakte (probleme me sy), probleme të zemrës dhe/ose vonesë zhvillimi. Gjithashtu mund të shkaktojë vdekjen e foshnjës ose vendimin për të kryer abort.



Jeni shtatzënë? – Vaksinat para, gjatë dhe pas shtatzënisë suaj

Mbrojtja nga rubeola gjatë shtatzënisë

Nëse keni bërë dy doza të vaksinës MMR kur ishit fëmijë, do të jeni të mbrojtur mirë gjatë shtatzënisë. Falë programit tonë të suksesshëm të vaksinimit, infeksioni i rubeolës tani është jashtëzakonisht i rrallë në MB.

Nëse nuk jeni të sigurt nëse e keni bërë vaksinën, mund të flisni me mjekun tuaj të përgjithshëm. Nëse nuk e keni bërë, duhet të vazhdoni me vaksinat tuaja, mundësisht para se të mbeteni shtatzënë. Përndryshe duhet ta bëni vaksinën menjëherë pas lindjes së fëmijës.

Vaksina MMR përmban një virus të gjallë (të dobësuar) prandaj nuk këshillohet gjatë shtatzënisë.

Unë jam tashmë shtatzënë, por nuk kam bërë MMR, çfarë duhet të bëj?

Vaksinat MMR mund t'i bëni pasi të keni lindur. Kjo do t'ju mbrojtë ju dhe fëmijën tuaj nga fruthi dhe rubeola. Bërja e të dyja dozave të MMR do t'ju japë gjithashtu mbrojtje afatgjatë kundër fruthit dhe shytave.

Skuqja e lëkurës gjatë shtatzënisë

Çfarë duhet të bëj nëse bie në kontakt me dikë që ka skuqje të lëkurës, ose nëse kam skuqje të lëkurës?

Disa infeksione që shkaktojnë skuqje të lëkurës, duke përfshirë rubeolën, mund të shkaktojnë komplikacione te gratë shtatzëna. Edhe nëse jeni të mbrojtur nga rubeola, duhet të njoftoni menjëherë maminë, mjekun e përgjithshëm ose mjekun obstetër nëse keni një sëmundje të skuqjes së lëkurës ose keni ndonjë kontakt me një person tjetër që ka skuqje të lëkurës në çfarëdo kohe gjatë shtatzënisë.

Ju lutemi shmangni çdo klinikë antenatale, mjedise materniteti ose gra të tjera shtatzëna derisa të jeni vlerësuar nga mjeku.

Mund t'ju bëhen teste për të zbuluar nëse jeni infektuar. Specialisti i shëndetësisë që bën vlerësimin do të ketë nevojë të dijë:

- sa javëshe shtatzënë jeni
- kur ka ndodhur kontakti me dikë që ka skuqje të lëkurës
- data kur ju është shfaqur për herë të parë ose kur keni pasur kontakt me dikë që ka skuqje të lëkurës
- një përshkrim i skuqjes së lëkurës (a është e ngritur, me gunga apo janë fluska të mbushura me lëng?)
- cilat infeksione keni pasur në të kaluarën, si lija, fruthi
- cilat vaksina keni bërë më parë

» Nëse keni kontakt me dikë që ka skuqje të lëkurës ose nëse keni një skuqje të lëkurës gjatë shtatzënisë, merrni këshilla nga mjeku juaj i përgjithshëm ose mamia sa më shpejt që të mundeni. Nëse vononi raportimin e një sëmundjeje të skuqjes së lëkurës, mund të mos jetë e mundur t'ju bëhet një diagnostikim i saktë ose t'ju jepet një trajtim i përshtatshëm.

Vaksina të tjera për t'i diskutuar me maminë tuaj

COVID 19

Rreziku nga infektimi me COVID-19 gjatë shtatzënisë është shumë më i ulët se sa ishte në fillim të pandemisë, por është ende e nevojshme që gratë shtatzëna të vaksinohen në vjeshtë. Vaksina do të zvogëlojë rrezikun që të sëmureni rëndë me COVID-19 për disa muaj, gjë që mund të jetë më e rëndësishme nëse keni ndonjë problem shëndetësor ekzistues. Antitruapat që trupi juaj prodhon kalohen te foshnja i palindur ende dhe i ofrojnë fëmijës një nivel mbrojtjeje në javët dhe muajt e parë të jetës.

Hepatiti B

Në lindje, foshnjat e lindura nga nënat që kanë infeksionin e hepatitit B (ose ato që rezultojnë pozitive për hepatitin B gjatë shtatzënisë) duhet ta bëjnë vaksinën e hepatitit B sapo të lindin. Duhet të merren masa me mjekun e përgjithshëm që fëmija juaj të marrë doza të mëtejshme të vaksinës dhe të bëjë një test gjaku të jetë 1 vjeç, për të testuar për infeksion. www.gov.uk/government/publications/protecting-your-baby-against-hepatitis-b-fletlet

BCG

Foshnjat e lindura nga një prind (ose që kanë një gjysh) nga një vend ku tuberkulozi është i përhapur, duhet të bëjnë vaksinën BCG për t'u mbrojtur ata TBC. www.gov.uk/government/publications/tb-bcg-and-your-baby-fletlet

» Bërja e vaksinave të rekomanduara gjatë shtatzënisë (dhe pasi fëmija juaj të lindë) është një nga gjërat më efektive që mund të bëni për të ulur rrezikun e infeksioneve të parandalueshme me vaksinë për ju dhe fëmijën tuaj.

Nëse fëmija juaj i bën vaksinat në moshën 8, 12 dhe 16 javë, kjo do të thotë që mbrojtja do të vazhdojë gjatë viteve më delikate të fëmijës.

Linqe për informacione të mëtejshme

- www.nhs.uk/Conditions/vaccinations/Pages/vaccination-schedule-age-checklist.aspx
- www.gov.uk/government/collections/immunisation
- www.medicines.org.uk/emc/
- Për të mësuar rreth vaksinave për fëmijën tuaj në vitin e parë të jetës, mund të lexoni www.gov.uk/government/publications/a-guide-to-immunisations-for-babies-up-to-13-months-of-age

Regjistrimi i vaksinës gjatë shtatzënisë

Regjistroni më poshtë vaksinat tuaja gjatë shtatzënisë për t'u siguruar që ju dhe foshnja juaj të mos lini pas dore mbrojtjen kundër gripit, kollës së mirë

Vaksinat	Kur ta bëni	Data kur bëhet
Gripi	Gjatë sezonit të gripit në çdo kohë gjatë shtatzënisë.	
Kolla e mirë	Mundësisht pas skanerit tuaj në javën 18 deri në 20 të shtatzënisë. Mund të bëhet nga java 16 jav deri në momentin e lindjes.	
RSV	Ju duhet të bëni vaksinën tuaj RSV sapo të jeni 28 javë shtatzënë.	
MMR doza 1*	Pasi të lindë fëmija juaj, në kontrollin e javës 6 pas lindjes (me mjekun e përgjithshëm ose infermieren).	
MMR doza 2*	Katër javë pas dozës së parë (si më sipër).	

*Nëse nuk ka vaksinë të mëparshme

**Bërja e vaksinave gjatë shtatzënisë
ndihmon në mbrojtjen e shtatzënisë.
Flisni me maminë, mjekun e përgjithshëm
ose ekipin shëndetësor dhe sigurohuni
që t'i bëni ato në kohën më të
përshtatshme për ju.**



© Crown copyright
2024 24PYPB01AL. 1P 250K OCT 2024
UK Health Security Agency gateway number: 2024694
Botuar për herë të parë në qershor 2024

Kjo fletëpalosje ofrohet gjithashtu e përkthyer në një sërë gjuhësh dhe formatesh të aksesueshme. Për të porositur kopje të tjera të kësaj fletëpalosjeje, vizitoni: www.healthpublications.gov.uk ose telefononi: 0300 123 1002, Minicom: 0300 123 1003 (08:00 deri në 18:00, nga e hëna në të premte)

www.nhs.uk/conditions/vaccinations/nhs-vaccinations-and-when-to-have-them